

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

|         |                                                                                                                                                                                                                                   |
|---------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| TITULLI | Dita e 113-të e protestës/ Qytetarët zbresin sërish në shesh, kërkohet dorëheqja e kryeministrit Rama: J u erdhi fundi!                                                                                                           |
| ADRESA  | <a href="https://dosja.al/live-updates/dita-e-113-te-e-protestes-qytetaret-zbresin-serish-ne-shesh-kerkohe-i515161">https://dosja.al/live-updates/dita-e-113-te-e-protestes-qytetaret-zbresin-serish-ne-shesh-kerkohe-i515161</a> |
| BURIMI  | dosja.al                                                                                                                                                                                                                          |
| GJENDJA | edited                                                                                                                                                                                                                            |

## KOHA


|                       |                                                                                                                                                           |
|-----------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| KAPUR NGA NE          | 20 shtator 2026, 17:05:27 UTC<br><i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>                            |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 20 shtator 2026, 16:55:00 UTC<br><i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i> |

## HASH-ET · SHA-256

|            |                                                                  |
|------------|------------------------------------------------------------------|
| PËRMBAJTJA | 80e646d64de13a1a90e0cab5568007e6bab07de959521f8827ea6572856548f8 |
| TEKSTI     | 6fcda229e81737696be9bcdee72e971259421df3db947f786d0bf08b351b0ea3 |
| PAMJA      | e93ccf0874752e4b1a8945dc6aae33c20614f494953eed40359c25fa38d5db3  |

## ZINXHIRI I PROVËS

|               |                                                                                                                                                                    |
|---------------|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| KJO HYRJE     | 87818992e08935467a46b00daaf1895936b55588b08c7dc23b4b3c25f7b1fba5                                                                                                   |
| E MËPARSHMJA  | aaa7732f9515abab8f1ed1e75d4aa9d14dd45f50771d8ee235ae4da441d1f5e                                                                                                    |
| RRËNJA MERKLE | —                                                                                                                                                                  |
| ANKORIMI      | nuk është ankoruar ende<br><i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i> |



## SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/87818992e08935467a46b00daaf1895936b55588b08c7dc23b4b3c25f7b1fba5>

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px





## LIVE UPDATES ▾

2 ORE ME PARE

Dita e 113-të e protestës/ Qytetarët zbresin sërish në shesh, kërkohet dorëheqja e kryeministrit Rama: Ju erdhi fundi!

10 ORE ME PARE

KËRCET ARMA NË SARANDË/ Ekzekutohet Artan Myrtaj nga 2 persona me motor, plagoset dhe një kalimtar

1 DITE ME PARE

112 ditë protesta kundër qeverisë/ Qytetarët mbledhen sërish në Bulevard, kërkojnë ndryshimin e Kodit Zgjedhor

1 DITE ME PARE

"Diaspora është me ne"/ Berisha: Rama është e shkuara, PD duhet të bëjë gjithçka për ripërtëritjen e saj

## LIVE UPDATES

## Dita e 113-të e protestës/ Qytetarët zbresin sërish në shesh, kërkohet dorëheqja e kryeministrit Rama: Ju erdhi fundi!

• Qytetarët u mbledhën sot në ditën e 113-të të revoltës së tyre. • Ata u organizuan fillimisht në sheshin "Skënderbej" dhe më pas vijuan marshimin drejt Kryeministrisë, ku dhe zhvilluan fjalimet e tyre. • Të shumtë ishin qytetarët të cilët folën në podiumin e vendosur para Kryeministrisë, ku artikuluan kërkesat e tyre dhe bënë thirrje për ndryshim. • Gjatë një prononcimi për mediat, profesori Lush Susaj u shpreh se qëllim i kësaj proteste është dorëheqja pa kushte e kryeministrit dhe autokracisë që ka mbledhur rreth tij. • Sipas tij, qeveria ka shkatërruar sistemin e shëndetësisë, arsimor, bujqësinë, pronat, sigurinë juridike. • Aktivisti Florjan Myftari tha se është momenti që protesta të marrë përgjegjësi e të propozojë ide në lidhje me mënyrën si do të vazhdojë. • Ai tha se protesta nuk është një lojë tavoline, por është një pikë serioze për Shqipërinë. • Aktivisti theksoi se vendit i duhet një zgjidhje reale dhe e vërtetë. • Një qytetare u ka bërë thirrje bizneseve të mbyllin qepenat dhe të dalin në protestë. • Gjatë fjalës së saj në podiumin e vendosur para Kryeministrisë, ajo tha se shqiptarët duan ndryshim, duke shtuar se janë ndryshimet e Kushtetutës në 2008, ato që e sollën vendin në këtë pikë. • Qytetarja u ndal edhe tek largimi i të rinjve dhe fëmijëve nga vendi, duke thënë se kjo është një prej dëshmive që qytetarët e shohin çdo ditë dhe se nuk ka nevojë për statistika për ta kuptuar situatën. • Aktivistja Arvina Lleshi ishte një nga folëset në protestën e ditës së sotme. • Gjatë fjalës së saj në podiumin e vendosur para Kryeministrisë, Lleshi u shpreh se më 24 shtator, pritet të votohen në parlament projektligjet për zonat e mbrojtura, për Paketën e Maleve dhe për investimet strategjike. • Në kuadër të kësaj, ajo ftoi qytetarët që të jenë para Parlamentit, për të protestuar. • Protesta e cila nisi si një reagim i drejtpërdrejtë ndaj situatës së ndodhur në Zvërnec, përfundoi në kërkesën për dorëheqjen e kryeministrit Edi Rama. • Me pankarta në duar dhe flamuj kuqezi, protestuesit kanë bërë thirrje për ndryshim. • Protesta ka bërë bashkë fëmijë, të moshuar, studentë, profesionistë, aktivistë dhe turistë. • Qytetarët kanë kërkuar plotësimin e pesë kërkesave të cilat përfshijnë dorëheqjen e panegociushme të kryeministrit Rama, krijimin e një qeverie teknike dhe ndryshime kushtetuese. • Tubimet janë shoqëruar me marshime nëpër rrugët kryesore të Tiranës, ndërsa qytetarët kanë ndaluar edhe pranë institucioneve të tjera, përfshirë Parlamentin, ku kanë përcjellë mesazhe ndaj deputetëve. • "Edi Rama, o tradhtar, me Shqipërinë mos bëj Pazar", "Rama, jep dorëheqjen", "Pari rini nuk ka Shqipëri", "Poshtë patronazhistët", "Shqipëria e shqiptarëve, vdekje tradhtarëve", "Shqipëria kërkon revolucion", "O Erion, o legen, prite Ramën se po vjen" dhe "Ju erdhi fundi". këto ishin disa nga thirrjet e tyre.

10 artikuj për këtë temë.

59 MINUTA ME PARE

### Protesta e 113-të/ Mbyllen fjalimet para Kryeministrisë, qytetarët nisin marshimin: Rama jepe dorëheqjen



#### editoriale

Andrey Kortunov

Zgjedhjet në Rusi janë më shumë sesa teatër politik

Irena Beqiraj

Fashizmi nuk duhet kërkuar tek revolta e protestuesve por në Kuvend!

Në vëmendje



Pamje

**TIRANA-** Protestuesit kanë mbyllur fjalimet para Kryeministrit. Nën thirrjet "Ju erdhi fundi", ata kanë nisur marshimin në rrugët e Tiranës dhe kanë finalizuar ditën e 113-të të revoltës së tyre.

Të shumtë ishin qytetarët të cilët folën në podiumin e vendosur para Kryeministrit ku bënë thirrje për ndryshim dhe kërkuan dorëheqjen e kryeministrit Edi Rama. "Edi Rama, jep dorëheqjen", "Ju erdhi fundi", "Rama në burg, Berisha në burg" dhe "Ndryshim sistemi" ishin disa prej sloganeve të përsëritura gjatë protestës.

Edhe sot, protesta ka spikatur duke bërë bashkë shtesa të ndryshme të shoqërisë, nga fëmijë e të moshuar, te studentë, profesionistë, aktivistë të cilët i janë bashkuar qëndresës qytetare./Dosja.al

#### 1 ORE ME PARE

## “Më 24 shtator, të gjithë para Parlamentit!”/ Aktivistja Arvina Lleshi: Deputetët do votojnë projektligjet antishqiptare, Shqipëria nuk është e qeverisë



Arvina Lleshi

**TIRANA-** Aktivistja Arvina Lleshi ishte një nga folëset në protestën e ditës së sotme. Gjatë fjalës së saj në podiumin e vendosur para Kryeministrit, Lleshi u shpreh se më 24 shtator, pritet të votohen në parlament projektligjet për zonat e mbrojtura, për Paketën e Maleve dhe për investimet strategjike. Në kuadër të kësaj, ajo ftoi qytetarët që të jenë para Parlamentit, për të protestuar.

POLITIKE 20 SHTATOR 2026, 16:00

Nga “George Washingtoni i Kosovës” te Haga/ Hashim Thaçi, njeriu i 17 shkurtit nën hijen e 16 shtatorit

POLITIKE 20 SHTATOR 2026, 15:54

Gjoka 110 mln euro e Arbitrazhit! Shqipëria u rrëzua edhe nga Gjykata e Apelit në Paris! Do i paguajë Becchetit edhe 20 mijë euro shtesë

AKTUALITET 20 SHTATOR 2026, 10:47

Vrasja në Sarandë/ Nëna sheh të birin e pajetë dhe shpërthen në lot: O djali i nënës (VIDEO)

### më të klikuarat

FOTO/ Kush është Artan Myrtaj që u ekzekutua ditën e sotme, viktima njihet si 'Tani Ruzhdiu'

KPP vë në rrezik sinjalin e RTSH-së. Bashkë me të dhe radiot e policisë dhe antenat e Shish e Albcontrol. Mban peng prej muajsh tenderin e mirëmbajtjes së rrjetit DVB-T2


VIDEO/ Falsifikim dokumentash dhe përfitim i paligjshëm i pronave, arrestohet ish-drejtori i Kadastrës në Fier, detyrim paraqitje për topografin

DETAJET/ Si u vra Artan Myrtaj në Sarandë, u qëllua nga dy persona me motor

### insights

Rezarta Gagani  
Përballë pallatit tim

Kjo duke theksuar se Shqipëria nuk është e qeverisë apo një grushti njerëzish, por është e njerëzve që punojnë çdo ditë dhe e çdo shqiptari që do të jetojë me dinjitet në vendin e tij. Ajo u shpreh se ligji duhet të jetë i njëjtë për të gjithë, pavarësisht pushtetit, pasurisë apo pozitës që mbajnë.



**Aktivistja Arvina Lleshi:** Ligji nuk është bërë vetëm për qytetarin e thjeshtë, ligji është bërë për të gjithë. Edhe për atë që ka pushtet, për atë që ka lekë, që ka lidhje, edhe për atë që ulet në zyrën më të madhe të shtetit. A e dini që në Shqipëri ligjet i bëjnë ata që nuk dinë të lexojnë, të artikulojnë dhe jo më të bëjnë ligje? Të enjten, më 24 shtator, pritet të votohen në parlament projektligjet antishqiptare për zonat e mbrojtura, për Paketën e Maleve dhe për investimet strategjike.

Unë ju ftoj që t'i lexoni vetë, shikoni çfarë ndryshojnë, kush përfiton dhe çfarë i mbetet qytetarit në fund. Duhet të jetë e qartë, Shqipëria nuk është e qeverisë, nuk është e një grushti njerëzish që sot janë në pushtet dhe nesër mund të mos jenë. Shqipëria është e jona, është e njerëzve që punojnë çdo ditë, është e atij që zgjohet në 5 të mëngjesit për të shkruar në punë, është e fermerit, është e mjeshtër, është e mjekut, studentit, emigrantit që ka ikur nga halli dhe jo nga dëshira. Është e çdo shqiptari që do të jetojë me dinjitet në vendin e vet.

Ne, më të vërtetë, mund të kemi bindje të ndryshme, por për disa gjëra duhet të jemi të gjithë bashkë. Për drejtësinë, për pronat dhe për natyrën. Për institucionet që respektojnë qytetarin, për një shtet ku ligji nuk ndryshon sipas emrit që ke. Më datë 24 shtator, ju ftoj të gjithë qytetarët të jenë para parlamentit. Për t'i thënë edhe një herë që nuk na përfaqësoni./Dosja.al

1 ORE ME PARE

## “Parlamenti nuk na përfaqëson”/ Qytetarja nga protesta: Shqiptarët duan ndryshim



Pamje

**TIRANA-** Një qytetare u ka bërë thirrje bizneseve të mbyllin qepinat dhe të dalin në protestë. Gjatë fjalës së saj në podiumin e vendosur para Kryeministrit, ajo tha se shqiptarët duan ndryshim, duke shtuar se janë ndryshimet e Kushtetutës në 2008. Ajo që e sollën vendin në këtë pikë

po ndërtohet një pallat

Auron Janku

Kur PARTITË harrojnë pse ekzistojnë

Ola Xama

Republika e 1 euroshit ku Rama zgjedh kush bëhet biznesmen


Idriz Konjari

Sa gati është biznesi shqiptar për tu përshtatur me tregun e BE-së?

Moti

Powered by  tomorrow

Më tej, ajo tha se Parlamenti nuk i përfaqëson qytetarët, pasi ka miratuar ligje që kanë dëmtuar kombin dhe të ardhmen. Qytetarja u ndal edhe tek largimi i të rinjve dhe fëmijëve nga vendi, duke thënë se kjo është një prej dëshmimeve që qytetarët e shohin çdo ditë dhe se nuk ka nevojë për statistika për ta kuptuar situatën.



*“Nuk kemi nevojë për statistika, na mjafton që kemi parë të rinjtë dhe fëmijët që janë larguar. Janë larguar sepse nuk kanë gjetur vendin e duhur, pavarësisht arsimit. Kudo shkojmë në Shqipëri dëgjojmë bizneset që thonë ‘jemi me ju dhe protestën jemi të gatshëm ta çojmë një hap më lart, të ulim qepenët të mos punojmë, të mos paguajmë taksat, të mbyllim bizneset gjatë ditësh, që administrata të mos ketë mundësi t’u trokasë në dyer’. Kur biznesi e ofron vetë këtë gjë imagjinoni ku kanë arritur. Me zor arrijnë plotësojnë pagat e punonjësve”, tha ajo./Dosja.al*

1 ORE ME PARE

## “Të zhbëhen ndryshimet kushtetuese të vitit 2008”/ Aktivisti: Duhet zgjidhje reale, Kuvendi nuk na përfaqëson



Florjan Myftari

**TIRANA-** Qytetarët kanë nisur fjalimet para Kryeministrit, ndërsa i pari që ka marrë fjalën është aktivisti Florjan Myftari. Duke folur para qytetarëve, ai u shpreh se është momenti që protesta të marrë përgjegjësi e të propozojë ide në lidhje me mënyrën si do të vazhdojë. Ai tha se protesta nuk është një lojë tavoline, por është një pikë serioze për Shqipërinë.

Aktivisti theksoi se vendit i duhet një zgjidhje reale dhe e vërtetë. Sipas tij, Shqipëria duhet të korrigjojë gabimet e Ramës dhe Berishës në 2008, ndryshimet kushtetuese që të marrim sovranitetin, pasi Parlamenti dhe mënyra se si është zgjedhur nuk përfaqëson qytetarët.



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.